



27/06/2026

Kamëz/Qëlloi Me Armë Zjarri Automatik Në Drejtim Të Një Servisi Celularësh, Në Babrru, Arrëstohet

Kamëz

Zbardhet dhe dokumentohet ngjarja e ndodhur më datë 26.06.2026, në Babrru.

Qëlloi me armë zjarri automatik në drejtim të një servisi celularësh, pas një konflikti për motive të dobëta me pronarin e tij, kapet dhe vihet në pranga 18-vjeçari.

Gjendet dhe sekuestrohet arma e zjarrit e përdorur në ngjarje, së bashku me municion luftarak.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 5, pas marrjes së njoftimit se në Babrru një shtetas kishte qëlluar me armë zjarri në drejtim të një servisi celularësh, organizuan menjëherë një operacion policor për identifikimin, lokalizimin dhe kapjen e autorit. Nga veprimet hetimore u dokumentua se autori i dyshuar, shtetasi R. M., 18 vjeç, pas një konflikti për motive të dobëta me pronarin e servisit, shtetasin Xh. I., ka qëlluar dy herë me armë zjarri automatike në drejtim të biznesit, duke shkaktuar vetëm dëme materiale në fasadën e jashtme dhe në ambientet e brendshme.


Në kuadër të operacionit policor “Zbulimi” të organizuar dhe të zhvilluar në një kohë shumë të shkurtër, shërbimet e Policisë lokalizuan, rreth 3 kilometra larg vendit të ngjarjes, kapën dhe vunë në pranga shtetasin R. M., 18 vjeç.

Gjatë kontrollit të zonës u gjet dhe u sekuestrua arma e zjarrit automatike, e përdorur në ngjarje, si dhe municion luftarak.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.



Kamëz/Qëlloi me armë zjarri automatik në drejtim të një servisi ce
Policia e Shtetit



◀ Qarku Shkodër/Goditen 2 raste të kultivimit të bimëve narkotike në fshatrat Ndrejaj dhe Vukël

Tiranë / Procedohen penalisht 15 shtetas ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Download on the App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

>

Arkiva

>

Akademia e Sigurisë

>

Ministria e Brendshme

>

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

>

Interpol

>

Europol

>

Misioni PAMECA V

>

SCPA

>

Projekti Trivalent